



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.74, Datë 10.05.2019

MBI

MIRATIMIN E “MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” NËNSHKRUAR MIDIS “OSHEE” SH.A DHE “KASTRATI ENERGY” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, nenit 20, pika 1 të Marrëveshjes së sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike dhe Furnizuesit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 24, datë 15.02.2017, dhe ndryshuar me Vendimin nr.58, datë 15.04.2019, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë "OSHEE" sh.a. dhe shoqërisë "KASTRATI ENERGY" sh.p.k..

Konstatoi se:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr. 6586/3 Prot., datë 15.04.2019, protokolluar me tonën me nr.300 Prot, datë 17.04.2019, ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike me nr. 6586/1 Prot datë 10.04.2019 të nënshkruar midis "OSHEE" sh.a. dhe "KASTRATI ENERGY" sh.p.k., me qëllim miratimin nga ERE të kësaj marrëveshje në zbatim të Vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.02.2017 "*Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE Sh.a dhe furnizuesit të energjisë elektrike*".
- Me Vendimin nr. 39, datë 07.03.2019 bordi i ERE-s, ka licencuar shoqërinë “KASTRATI ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr.96, datë 27.10.2014, të ndryshuar me vendimin nr.216, datë 11.10.2018 dhe me vendimin nr.264, datë 20.12.2018; ka licencuar shoqërinë “Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike” sh.a në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, për një afat 30-vjeçar.
- Në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.24, datë 15.02.2017, në nenin 20, pika 1, përcaktohet se ” Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE”.
- Marrëveshja për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike e nënshkruar midis "OSHEE" sh.a dhe "KASTRATI ENERGY" sh.p.k ka reflektuar saktësisht të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.24, datë 15.02.2017.
- Bordi i ERE-s me Vendimin Nnr.58, datë 15.04.2019, ka vendosur “*Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE sh.a) dhe Furnizuesit*”.
- Duke qenë se Marrëveshja për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike e nënshkruar midis "OSHEE" sh.a dhe "KASTRATI ENERGY" sh.p.k mban datën 10.04.2019 dhe hyn në fuqi me miratimin nga ERE, ndryshimet e Vendimit nr.58, datë 15.04.2019 do të reflektohen në të.
- Me shkresën nr.201 Prot, datë 04.03.2019 të gjitha palët e interest janë njoftuar edhe njëherë me përmbajtjen e *disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE sh.a) dhe Furnizuesit* të propozuara nga OSHEE sh.a
- Vendimi nr.58, datë 15.04.2019, ka vendosur “*Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE sh.a) dhe Furnizuesit dhe.ka miratuar ndryshime në dispozitat e marreveshjes tip të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr.24, datë 15.02.2017,*

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE:

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “OSHEE” sh.a. për “*Miratimin e marrëveshjes për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nr.6586/1 Prot, datë 10.04.2019 nënshkruar midis shoqërisë "OSHEE" sh.a dhe shoqërisë "KASTRATI ENERGY" sh.p.k*”.

2. Ndryshimet e miratuara me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.58, datë 15.04.2019, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEEsha) dhe Furnizuesit” do të zbatohen për të gjitha Marrëveshjet për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjise Elektrike që janë lidhur dhe do të lidhen në vijim nga OSHEE sh.a me Furnizuesit, pas hyrjes në fuqi të vendimit nr.58, datë 15.04.2019 të Bordit të ERE.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI